



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 355/prot.
5

Tiranë më 0404.2019

VENDIM

Nr. 04, datë 04.04.2019

PËR KONTROLLUESIN “*TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K (TIA)*”,

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 28.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”, me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi me iniciale P.L, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit, kryesisht u fokusua në drejtim të proceseve përpunuese që kryen kontrolluesi në kuadër të sigurisë, implementuar dhe zbatuar nga Departamenti i Sigurisë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”, konstaton se:

1. Kontrolluesi “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*” i ka deleguar shërbimet e sigurisë së aviacionit te kompania ICTS Albania Sh.p.k, me përjashtim të procesit të prodhimit dhe dhënies së kartave ID të aeroportit sipas niveleve të aksesit në zona të

ndryshme të aeroportit. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të pajisjes me karta ID kryhet nga specialisti i dhënies së kartave ID në varësi të Departamentit të Sigurisë. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të pajisjes me kartën ID kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet plotësimit të formularëve dhe dorëzimit të dokumenteve përkatëse) dhe elektronike (nëpërmjet sistemit SiPass) për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale, punonjës të TIA, nënkontraktorëve të saj, kompanive ajrore, policisë së shtetit, diplomatëve etj.

2. Kontrolluesi nuk ka parashikuar politika dhe rregulla mbi informimin e subjekteve të të dhënave personale (personave që aplikojnë për kartat ID të aeroportit), në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, lidhur me fushën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale, personin që do ti përpunojë të dhënat, mënyrën e përpunimit, të drejtat që gëzojnë subjektet dhe masat e sigurisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Informimi i subjekteve të të dhënave duhet të bëhet përpara ose në momentin e mbledhjes së të dhënave personale. Në rastin konkret ky informim mund të realizohet nëpërmjet “Formularit të aplikimit për kartat ID të aeroportit”.

3. Në kontratën e delegimit të shërbimeve të sigurisë së aeroportit, midis kontrolluesit TIA dhe përpunuesit ICTS Albania Sh.p.k, nuk parashikohen detyrimet e palëve në kuadër të zbatimit të nenit 20 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si shumë të rëndësishme parashikimin e detyrimeve midis kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të shërbimeve, sa i përket parashikimit të kushteve teknike dhe organizative dhe masave të sigurisë, konfidencialitetit, garantimit të drejtave të subjekteve dhe se çfarë do të ndodh me të dhënat personale të përpunuara, pas përfundimit të efekteve ligjore të kontratës. Kjo sjell si nevojë specifikimin e detyrimeve midis palëve në kontratën e lidhur midis tyre.

4. Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe miratuar një Rregullore të Brendshme lidhur me procedurat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë fizike dhe teknike në kuadër të përpunimit të të dhënave personale gjatë procesit të prodhimit dhe pajisjes me kartë ID të aksesit në Aeroport për personat e autorizuar (dhe proceset e tjera përpunuese), përcaktimin e të drejtave të aksesit, mënyrat dhe procedurat e shkatërrimit të sigurtë dhe konfidencial të dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale pas mbarimit të qëllimit të përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave

personale dhe mënyrat e ushtrimit të tyre, etj. Detyrimi i kontrolluesit TIA për hartimin e rregullores është parashikuar edhe në Urdhrin nr.10, datë 22.04.2014, të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e detyrueshme për çdo punonjës të kontrolluesit, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj, konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale të kontrolluesit për çdo kategori subjektësh të të dhënave, sipas deklarimeve në “Formularin e Njoftimit”.

Gjithashtu në referim të kreut IV, të Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2018, për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, Zyra e Komisionerit vlerëson se është e nevojshme, që në cilësinë e kontrolluesit, me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmerren masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.

5. Formularët e aplikimit për kartat ID të aeroportit dhe kartat ID jo të vlefshme, që përmbajnë të dhëna personale të personave të autorizuar për akses në ambientet e aeroportit, mbahen në ambiente të hapura dhe të pasigurta. Në këtë kuadër janë administruar në cilësinë e provës, foto të ambientit ku ishin ekspozuar këto dokumente.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekspozimi i këtyre formularëve që përmbajnë të dhëna personale përbën risk lidhur me sigurinë e tyre. Kontrolluesi, në kuadër të garantimit të sigurisë fizike të të dhënave personale dhe ndalimit të aksesit nga persona të paautorizuar, duhet të ndërmarrë masa lidhur me ruajtjen e tyre në dollape me çelës të aksesueshëm vetëm nga personat e autorizuar.

6. Kartat ID që ju kishte mbaruar afati i vlefshmërisë, mbahen nga ana e kontrolluesit në tejkalim të qëllimit të përpunimit. Kartat ishin vendosur në një qese të tejdukshme dhe mbaheshin në tavolinën e specialistit përkatës i ngarkuar me detyrën e printimit të tyre.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi ka detyrim që të përpunojë të dhënat personale për atë kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/1/d) dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave do të konsiderohej i paligjshëm. Në këtë kuadër, lind nevoja që kontrolluesi të parashikojë

masa për mbajtjen e kartave për aq sa kanë përmbushur qëllimin e përpunimit dhe më pas të realizojë shkatërrimin, në rast se nuk ka një bazë ligjore për mbajtjen e mëtejshme të tyre.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 15.03.2019), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 26.03.2019, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e kontrolluesit, paraqitën të njëjtat pretendime të përcjella me shkresën nr.355/4 prot, datë 25.03.2019, të përmbledhura si më poshtë:

- Lidhur me detyrimin për informim janë kryer ndryshimet në formularët e aplikimit për kartat ID të aksesit në ambientet e aeroportit, duke shtuar edhe klauzolën e pëlqimit;
- Lidhur me kontratën midis TIA dhe ICTS, në të janë parashikuar rregulla mbi sekretin tregtar dhe detyrimi i ICTS për garantimin e konfidencialitetit (referuar Aneksit L, pika E dhe Aneksit A të kontratës);
- Lidhur me hartimin e rregullores së brendshme, TIA ka marrë masa duke e hartuar atë dhe ndërkohë është duke bërë ndryshime në përputhje me konstatimet e grupit të inspektimit. Në këtë kuadër është paraqitur gjatë seancës dëgjimore një standard rregullorje;
- Lidhur me sigurinë fizike të formularëve të aplikimit për kartat ID të aeroportit, theksojnë se zyra është e mbyllur dhe përdoret vetëm nga personi i autorizuar;
- Lidhur me shkatërrimin e kartave ID që ju kishte mbaruar afati i vlefshmërisë, TIA ka marrë përsipër masa për të kryer shkatërrimin e tyre.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Sa i përket plotësimin të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, kontrolluesi pavarësisht njoftimit mbi marrjen e masave nuk ka paraqitur prova lidhur me plotësimin e këtij detyrimi. Konkretisht nuk ka paraqitur asnjë paragraf informues të përfshirë në formularin përkatës;
- Sa i përket parashikimit të detyrimeve përkatëse të palëve, në kontratën e delegimit të shërbimeve të sigurisë së aeroportit, në kuadër të zbatimit të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dispozitat e referuara nga kontrolluesi nuk përmbushin elementët e këtij neni (citur më sipër) dhe Udhëzimit të Komisionerit nr. 19, datë 03.08.2012 mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit në një kontratë tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar. Në këtë kontratë nuk parashikohen detyrimet specifike të përpunuesit sa i përket aksesit të tij në sistemin CCTV të aeroportit, sistemin e hyrje-daljeve në ambientet e

aeroportit dhe shërbime të tjera të deleguara nga kontrolluesi që parashikojnë përpunim të të dhënave nga ana e përpunuesit.

- Sa i përket pretendimeve lidhur me hartimin e një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, Zyra e Komisionerit thekson se pavarësisht faktit që kjo e fundit nuk është paraqitur gjatë inspektimit, por në seancë, përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi dhe kategorive të subjekteve të të dhënave (deklaruar në Formularin e Njoftimit), në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Zyra e Komisionerit. Ajo nuk reflekton të gjitha proceset përpunuese.

Sqarojmë se parashikimet në rregullore ndryshojnë nga kontrolluesi në kontrollues, në varësi të fushës së veprimtarisë, mjeteve dhe mënyrës së përpunimit, kategorisë së të dhënave dhe subjekteve të të dhënave personale, etj. Në këtë kuadër është detyrim i çdo kontrolluesi që të analizojë elementët e veprimtarisë përpunuese dhe të hartojë dhe miratojë rregulloren e brendshme në frymën e parashikimeve ligjore.

- Sa i përket masave të sigurisë fizike për formularët e aplikimit për kartat ID dhe shkatërrimit të kartave ID që ju ka mbaruar afati i vlefshmërisë, nuk është paraqitur asnjë provë lidhur me masat e marra.

Kontrolluesi “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”, bën pjesë në kategorinë e kontrolluesve të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2018, për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.

Për këtë arsye si dhe për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron dhe masave të shtuara të sigurisë që ky i fundit kërkon në aspekt të mbrojtjes së të dhënave, kontrolluesi në fjalë, me qëllim garantimin e këtij niveli sigurie duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin 48 datë 14.09.2018 “Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” duke çertifikuar sistemin e sigurisë së menaxhimit të të dhënave në përputhje me kërkesat e këtij të fundit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat “a”, “b”, “ç” dhe “dh” të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

1. *Kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
2. *Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
3. *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
4. *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara*

përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Në bazë të nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze dhe nuk është reflektuar lidhur me zbatimin e Urdhrit nr.10, datë 22.04.2014, të dhënë më parë nga Zyra e Komisionerit. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5/1/d, 18, 20, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat “a”, “b”, “ç” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*” me gjobë, në vlerën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*” me gjobë, në vlerën **300 000 (treqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*” me gjobë, në vlerën **300 000 (treqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
4. Dënimin e kontrolluesit “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*” me gjobë, në vlerën **150 000 (njëqindpesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
5. Kontrolluesi “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”, me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.
6. Kontrolluesi “*Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)*”, të ndërmarrë masa për garantimin e sigurisë fizike të formularëve të aplikimit për kartat ID të aeroportit dhe për shkatërrimin e menjëhershëm të kartave ID që ju ka mbaruar afati i vlefshmërisë.

7. Kontrolluesi **"Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)"**, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme duke çertifikuar sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.
8. Kontrolluesi **"Tirana International Airport Sh.P.K (TIA)"**, ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, brenda 30 ditëve, ndërsa për pikën 7 brenda 90 ditëve nga marrja dijëni e aktit.
9. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 04.4.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

